

AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE "RTS" Shpk

Ne baze te ligjit nr. 9901 date: 14.04.2008 " Per shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723 date: 03.05.2007 " Per qendren Kombetare te Rregjistrimit", sot ne date 10.03.2014, ne te nenshkruarit:

Erjola Brahelika, e bija e Sadik dhe Farie, datelindja 19.02.1988 lindur ne Bruç, Mat dhe banues ne Tirane, madhor , me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim nr :030980449

Ermelinda Ndrenika, e bija e Elmas dhe Penete, datelindja 13.09.1978 lindur ne Fier dhe banues ne Tirane madhor, me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftim nr :025463459,

Luan Caca, i biri i Myfit dhe Lumturi , datelindja 04.11.1974, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim nr :024404493, dhe

Gerti Zotkaj, i biri i Sokol dhe Anila , datelindja 21.01.1989, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim nr :029159761, te katert me zotesi te plote juridike per te vepruar me vullnetin e tone te lire dhe te plote, perpijome kete Akt Themelimi.

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "RTS" Shpk, me themelues: Znj. Erjola Brahelika, Znj. Ermelinda Ndrenika, Z. Luan Caca dhe Z. Gerti Zotkaj.

Neni 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesve te saj ne kapitalin themeltar.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise, marredheniet e saj me persona te trete juridike e fizike, vendas dhe te huaj, shtetror dhe privat, rregullohen ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise per shoqerite tregtare, si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij legjislacioni.

Neni 4

Shoqeria e ka seline e saj ne adresen: Autostrada Tirane-Durres, km 7 (godina e "ITE" grup.al). Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose/edhe jashte vendit.

Neni 5

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise per nje periudhe te pacaktuar.



Neni 6

Objekti i veprimtarise se saj do jete :

Ushtrimi i tregtise me shumice e pakice te mallrave dhe produkteve te fushes se teknologjise se informacionit dhe komunikimit. Prodhim, projektim, implementim, mirembajtje dhe konsulence per produkte dhe mallra dhe sherbime te fushes se teknologjise se informacionit.

Import - Eksport, tregtim me shumice e pakice te sistemeve, seteve pajisjeve, mjeteve e programeve informatike, elektronike e mekanike;

Ofrim sherbimesh dhe asistence, krijim programesh, modelesh dhe sistemesh,ne fushen e informatikes, elektronikes dhe mekanikes.

Sherbime ne teknologjine e informacionit: Projektim, ndertim, operim dhe integrim sherbimesh telefonike te operatoreve te ndryshme, projektim dhe realizim sistemesh telefonike, sherbime telefonie ne perputhje me teknologjine e kohes dhe hapsiren ligjore, sherbime te tjera te lidhura me telefonine.Projektim, ndertim, operim dhe integrim sherbimesh te transmetimit te te dhenave dhe internetit ne firba optike, sisteme radiorele, satelitore etj. Projektim, ndertim, operim dhe integrim sistemesh te perpunimit te te dhenave dhe automatizimit te preeseve si dhe krijimi i nyjeve perkatese. punime civile, kanalizime, shtrim kabllorsh per llogari te kontratave te ndryshme te ndertimit, telekomunikacionit dhe komplekse, lidhja e kontratave te sipermarrrjes si dhe zhvillimi i te gjitha aktiviteteve te lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e teknologjise se informacionit perfshire aktivitetin e ndermjetesimit ne lidhje me sistemet e teknologjise se informacionit , projekteve te ndryshme etj . Realizimin dhe aktivitetin e drejtimit te impianteve, aparaturave dhe teknologjive te ndryshme ne fushen e industrise.

Perfaqesimin direkt, si agjent ose mbi baza porosie, te shoqerive qe veprojne ne sektorin e teknologjise se informacionit.

Organizimi dhe zhvillimi i matjeve te ndryshme te shikueshmerise se programeve te ndryshme ne radio dhe televizion, pergatitja e raporteve perkates bazuar ne te dhenat e perfituar nga keto matje, si dhe tregtimin e format te ndryshme e ketyre raporteve.

Projektim, shitje, dizenjim, konsulence, implemnetim dhe mirembajtje te sistemeve te autentifikimit, firmes dhe nenshkrimit elektronik dhe infrastrukturave te çelsit publik.

Instalime, kabllime te rrjetave kompjuterik, elektrik, telefonik, kamerave, akses kontrollit dhe te sigurise.

Trajnime dhe certifikime.

Ngritje e sistemeve dhe e qendrave te te dhenave dhe hostim te te dhenave.

Projektim,zbatim,automatizim,supervizim,mirembajtje te rrjeteve dhe sistemeve elektrike.

Projektim,zbatim,automatizim,mirembajtje te linjave te konjeksionit dhe interjonjeksionit(high-voltages,middle-voltage dhe low-voltage).

Prodhim,transmetim,shitje te energjise elektrike(kundrejt operatoreve vendas shteterore dhe private si dhe ne tregjet jashte vendit).

Projektim,zbatim,supervizim,mirembajtje te sistemeve te kondicionimit.

Trajnim dhe certifikim te profesioneve:elektracist,hidraulik.

Certifikim te lojrave te fatit me dhe pa ekran,te lojrave me shume lojtare(multiplayers),si dhe te lojrave argetuese.

Projektim,zbatim,supervizim,mirembajtje te sistemeve ne sektorin e :



Kazinove, ipodromeve, lotarive kombetare, basteve sportive, bingove dhe kazinove elektronike.

Ushtrimi i tregtise me shumice e pakice i artikujve te ndryshem industrial , ushqimor , kafe-bufe, import--eksport, shfrytezim, prodhim, tregtim i lendes drusore, punime pyjore.

Trajnim, konsulence dhe asistence finaciare, fiskale kontabile

Kembim valuator, organizime turistike, bileta udhetimi, perkthime guida turistike , mallra te konsumit te perditshem, produkte ushqimore.

Trajnim, konsulence, asistence teknologjike teknike, tregtim elektroshtepiake frigorifere, Lavatrice.

Perfaqesime tregtare , Import export te produkteve te teknologjise se larte, produkteve te dixhitalizuara, Programeve informatike, instalimin e sistemeve te sigurise se larte, tregtim i materialeve te renda, produkteve te pergjimit, import export te armeve te renda, tanke, helikoptere, anije.

Studim, projektim, perpunim, shfrytezim i produkteve nentokesore, mineraleve te kromit, gureve dekorative, mermerit etj, si dhe import-eksport i tyre.

Import eksport dhe tregtim i lenedevet plasese dhe shperthyese qe perdoren per perdorim civil.

Projektim , zbatim dhe ndertim.

Import dhe Export te paisjeve laboratorike, mjeksore, industriale, import export te barnave mjekesorekitive dhe reagenteve laboratorike.

Tregtim dhe mbeshtetje teknike per aparatura gjeodezike, topografike, ndertimore, hidrometerologjike. Aparatura te teknologjise se larte, Laser, X-Ray, Scanera 3D etj.

Import--eksport te materialeve te ndryshme.

Prodhim dhe tregtim produktesh metalike, druri, brumi, energjie, kasafortash, dyer te blinduara, dollape, arshiva dhe tavolina metalike, mobiljeve, etj

Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit, punime karpentere.

Sherbime Hotelerie dhe biznesi, Bar-kafe Restorant.

Transport mallrash brenda dhe jashte vendit, etj.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke, i formuar nga ortakët e shoqerise :

Znj. Erjola Brahelika, Znj. Ermelinda Ndrenika, Z. Luan Caca dhe Z. Gerti Zotkaj.

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte :

Znj. Erjola Brahelika, 25'000 leke, perkatesisht 25% te kuotave.

Znj. Ermelinda Ndrenika, 25'000 leke, perkatesisht 25% te kuotave.

Z. Luan Caca, 25'000 leke, perkatesisht 25% te kuotave.

Z. Gerti Zotkaj 25'000 leke, perkatesisht 25% te kuotave.

Ky kapital ndahet ne 100 pjese te barabarta, vlere nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1'000 leke. Vlera nominale e nje kuote eshte 1'000 leke.

Neni 8

Veprimtaria e shoqerise, emertimi e selia e saj, te percakuara ne kete akt themelimi, nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e themeluesve te saj.

Neni 9

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

Neni 10

Administratori i shoqerise "RTS" Shpk eshte Z. Luan CACA, me nje mandat 5-vjecar, me te drejte riparteritjeje te ketij mandati.
Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

Neni 11

Ky akt u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise, duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.
Akti u perpilua ne 4 (kater) kopje, secila me fuqi te barabarte, per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe per t'u shperndare ne organet kompetente, dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

Ortaket e shoqerise :

----- Erjola Brahelika

Erjola Brahelika

----- Luan Caca

Luan Caca


Ermelinda Ndrenika

Ermelinda Ndrenika
Gerti Zotkaj

D. 11-03-2014



Juan Carlos
Garcia



Juan Coca
Guti



Juan Carlos
Garcia

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA
Red Technology Solution ("RTS")SHPK

Me cilesine e ortakeve :

1.Erjola Brahelika, e bija e Sadik dhe Farie, datelindja **19.02.1988** lindur ne Bruç, Mat dhe banues ne Tirane, madhor , me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim **nr :030980449**

2.Ermelinda Ndrenika, e bija e Elmas dhe Penete , datelindja **13.09.1978** lindur ne Fier dhe banues ne Tirane madhor, me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftim **nr :025463459**

3.Luan Caca, i biri i Myfit dhe Lumturi , datelindja **04.11.1974**, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim **nr :024404493**

4. Gerti Zotkaj, i biri i Sokol dhe Anila , datelindja **21.01.1989**, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim **nr :029159761**
te cilet me cilesine e "ortakeve Themelues" me kerkuan redaktimin e ketij statuti, nepermjet te cilit ata deklaruan se me vullnet te lire, te plote e te singerte dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" ne kodin doganor dhe ligjet fiskale krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuara me emertimin "RTS"sh.p.k (me poshte e quajtur " Shoqeria ")

Kreu I

Neni 1


Krijimi

Shoqeria "RTS " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria "RTS " shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaket, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne autostraden Tirane-Durres, km 7(godina e "ITE" grup.al)

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e :

Ushtrimin e tregtise me shumice e pakice te mallrave dhe produkteve te fushes se teknologjise se informacionit dhe komunikimit. Prodhim, projektim, implementim, mirembatje dhe konsulence per produkte dhe mallra dhe sherbime te fushes se teknologjise se informacionit.

Import - Eksport, tregtim me shumice e pakice te sistemeve, seteve pajisjeve, mjeteve e programeve informatike, elektronike e mekanike;

Ofrim sherbimesh dhe asistence, krijim programesh, modelesh dhe sistemesh,ne fushen e informatikes, elektronikes dhe mekanikes.

Sherbime ne teknologjine e informacionit: Projektim, ndertim, operim dhe integrim sherbimesh telefonike te operatoreve te ndryshme, projektim dhe realizim sistemesh telefonike, sherbime telefonie ne perputhje me teknologjine e kohes dhe hapsiren ligjore, sherbime te tjera te lidhura me telefonine.Projektim, ndertim, operim dhe integrim sherbimesh te transmetimit te te dhenave dhe internetit ne firba optike, sisteme radiorele, satelitore etj. Projetkim, ndertim, operim dhe integrim sistemesh te perpunimit te te dhenave dhe automatizimit te prceseve si dhe krijimi i nyjeve perkatese. punime civile, kanalizime, shtrim kabllosh per llogari te kontratave te ndryshme te ndertimit, telekomunikacionit dhe komplekse, lidhja e kontratave te sipermarrjes si dhe zhvillimi i te gjitha aktiviteteve te lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e teknologjise se inforamcionit perfshire aktivitetin e ndermjetesimit ne lidhje me sistemet e teknologjise se informacionit , projekteve te ndryshme etj . Realizimin dhe aktivitetin e drejtimit te impianteve, aparaturave dhe teknologjive te ndryshme ne fushen e industrise. Perfaqesimin direkt, si agjent ose mbi baza porosie, te shoqerive qe veprojne ne sektorin e teknologjise se inforamcionit. Organizimi dhe zhvillimi i matjeve te ndryshme te shikueshmerise se programeve te ndryshme ne radio dhe televizion, pergatitja e raporteve perkates bazuar ne te dhenat e perfituar nga keto matje, si dhe tregtimin e format te ndryshme e ketyre raporteve.

Projektim, shitje, dizenjim, konsulence, implemnetim dhe mirembatje te sistemeve te autentifikimit, firmes dhe nenshkrimit elektronik dhe infrastrukturave te çelsit publik.

Instalime, kabllime te rrjetave kompjuterik, elektrik, telefonik, kamerave, akses kontrollit dhe te sigurise.

Trajnime dhe certifikime.

Ngritje e sistemeve dhe e qendrave te te dhenave dhe hostim te te dhenave.

Projektim,zbatim,automatizim,supervizim,mirembajtje te rrjeteve dhe sistemeve elektrike.

Projektim,zbatim,automatizim,mirembajtje te linjave te konjeksionit dhe interjonjeksionit(high-voltages,middle-voltage dhe low-voltage).

Prodhim,transmetim,shitje te energjise elektrike(kundrejt operatoreve vendas shtetere dhe private si dhe ne tregjet jashte vendit).

Projektim,zbatim,supervizim,mirembajtje te sistemeve te kondicionimit.

Trajnim dhe certifikim te profesioneve:elektracist,hidraulik.

Certifikim te lojrave te fatit me dhe pa ekran,te lojrave me shume lojtare(multiplayers),si dhe te lojrave argetuese.

Projektim,zbatim,supervizim,mirembajtje te sistemeve ne sektorin e :

Kazinove,ipodromeve,lotarive kombetare,basteve sportive,bingove dhe kazinove elektronike.

Ushtrimi i tregtise me shumice e pakice i artikujve te ndryshem industrial , ushqimor , kafe-bufe, import-eksport, shfrytezim, prodhim, tregtim i lendes drusore, punime pyjore.

Trajnim, konsulence dhe asistence finaciare, fiskale kontabile

Kembim valuator, organizime turistike, bileta udhetimi, perkthime guida turistike , mallra te konsumit te perditshem, produkte ushqimore.

Trajnim, konsulence, asistence teknologjike teknike, tregtim elektroshtepiake frigorifere, Lavatrice.

Perfaqesime tregtare , Import export te produkteve te teknologjise se larte, produkteve te dixhitalizuara, Programeve informatike, instalimin e sistemeve te sigurise se larte, tregtim i materialeve te renda, produkteve te pergjimit, import export te armeve te renda, tanke, helikoptere, anije.

Studim, projektim, perpunim, shfrytezim i produkteve nentokesore, mineraleve te kromit, gureve dekorative, mermerit etj, si dhe import-eksport i tyre.

Import eksport dhe tregtim i lenedevet plasese dhe shperthyese qe perdoren per perdorim civil.

Projektim , zbatim dhe ndertim.

Import dhe Export te paisjeve laboratorike, mjeksore, industriale, import export te barnave mjekesorekive dhe reagenteve laboratorike.

Tregtim dhe mbeshtetje teknike per aparatura gjeodezike, topografike, ndertimore, hidrometerologjike. Aparatura te teknologjise se larte, Laser, X-Ray, Scanera 3D etj. Import-eksport te materialeve te ndryshme.



Prodhim dhe tregtim produktesh metalike, druri, brumi, energjie, kasafortash, dyer te blinduara, dollape, arshiva dhe tavolina metalike, mobiljeve, etj

Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit, punime karpentere.

Sherbime Hotelerie dhe biznesi, Bar-kafe Restorant.

Transport mallrash brenda dhe jashte vendit, etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 LEKE

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga "ortaket " e shoqerise :

Erjola Braheli kazoterues i 25% kuotave, me vlere te pergjithshme 25.000 Leke, te cilat perfaqesojne 25% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ermelinda Ndrenika zoterues i 25 % kuotave, me vlere te pergjithshme 25.000 Leke, te cilat perfaqesojne 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Luan Caca zoterues i 25 % kuotave, me vlere te pergjithshme 25.000 Leke, te cilat perfaqesojne 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Gerti Zotkaj zoterues i 25 % kuotave, me vlere te pergjithshme 25.000 Leke, te cilat perfaqesojne 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributet e ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

Ortaket pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;



Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, në shërbime, nepermjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës me vendimin e asamblesë së ortakëve.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogelohet me vendim të Asamblesë së ortakëve në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimie
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve vendos per çeshtje si:

- a)percaktimi i politikave tregtare te shoqerise (kuorum 50+1 te kuotave);
- b)emerimin dhe shkarkimin e administrator-it –eve (kuorum 60+1 te kuotave);
- c) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar (kuorum 60+1 te kuotave);
- ç) percaktimin e shperblimeve (kuorum 50+1 te kuotave)
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator-i -et, perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; (kuorum 50+1 te kuotave)
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; (me perfaqesues te zgjedhur me kuorum 50+1 te kuotave)
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese (kuorum 50+1 te pranishme);

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

a)miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise (kuorum 60+1 te kuotave);

shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve (kuorum 50+1 te kuotave);

Investime (unanim);

ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise (unanim);.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z. Luan Caca.

Administratori e shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortaketerise.

Neni II

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve; perfaqesoje shoqerine tregtare;
 - c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - ç) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
 - d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- raportojte perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare'

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e Asambleja e Pergjithshme Ortakeve edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortaketerise te shoqerise.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi cheshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç;) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administrator-i-et, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarë

4. Ne menyre te vecante por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortak-ut-ve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, ndahen ne perpjestim me kuotat qe kane ortakët.



Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tij;

me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit.

Likuiduesi i nenshtrohet mbikeqyrjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarketuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të paperfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës perkatese nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi për gatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në castin e mbylljes së ketyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat me shumë se një vit, likuiduesi për gatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asamblëja e përgjithshme e ortakeve.

Neni 20

Perfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç' regjistrimin e shoqërisë. Në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalojnë të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblëse së Përgjithshme të Ortave, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur.



2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008"

3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e ketij te fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje: kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;

Berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;

vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V, te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likujdimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te tij ne shoqeri aksionare

Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plate me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.



Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua nga ne "Ortaket e kesaj shoqerie" ne 6 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKET

Erjola Brahelika Melaupfo
Erjola Brahelika

Luan Caca Guri
Luan Caca

Ermelinda Ndrenika
Ermelinda Ndrenika

Gerti Zotkaj
Gerti Zotkaj

[Signature]

DH. 11-03-2014